



## Ndahen çmimet për sipërmarrjen “Bleta e Artë” 2016



Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, nën kujdesin e veçantë të kryeministrit, z. Edi Rama, organizoi për të katërtin vit rresht eventin “Bleta e Artë”. Eventi u zhvillua më 28 dhjetor, në Pallatin e Kongreseve. Qëllimi i këtij event është vlerësimi dhe promovimi i sipërmarrjes shqiptare, i punës dhe kontributit të saj në zhvillimin ekonomik të vendit dhe në rritjen e punësimit. Nga rreth 50 kompani të nominuara, u shpallën fituese në kategori të ndryshme 11 biznese, ndërkohë që dy çmime të posaçme u dhanë për Administratorin dhe Administratoren e vitit 2016. Në fjalën e saj, Ministria Milva Ekonomi foli për sfidat e sipërmarrjes në vitin që po lëmë pas si dhe për sukseset e saj. Ministria tha se sipërmarrja ka rolin e vet në zhvillimin ekonomik të vendit. “Rritja ekonomike që kemi sot, prej 3.4 %, nuk do të ishte e mundur në qoftë se sipërmarrja nuk do të kishte marrë përsipër sfida dhe iniciativa”, tha Ekonomi. Ajo shtoi se falë reformave të ndërmarra nga qeveria dhe sipërmarrja ka përfituar lehtësira tatimore, ku rreth 86 mijë biznese përfituan rreth 1.6 miliardë lekë falë sistemit të taksave që ndryshoi. “Si rrjedhojë bizneset u bënë të afta që të prodhonin më shumë, prandaj dhe prodhimi këtë vit i sipërmarrjes u rrit me 7.5 %. Ato mundën të eksportonin më shumë dhe sot kemi një rritje të numrit të ndërmarrjeve prej 24 %, të cilat punësuan më shumë individë, ndaj kemi 173 mijë njerëz që janë punësuar më shumë në sipërmarrjet shqiptare”, tha znj. Ekonomi. Të pranishëm në event ishin kryeministri i vendit z. Edi Rama; ministri i Financave, z. Arben Ahmetaj; ministria e Kulturës; znj. Mirela Kumbaro; ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, znj. Ermonela Felaj; ministria e Zhvillimit Urban, znj. Eglantina Gjermani; kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erjon Veliaj, zv/ministra, deputetë, biznesmenë, drejtues të bizneseve, përfaqësues të Dhomave të Tregtisë e Industrisë vendase dhe të huaja.

### Fituesit e 'Bleta e Artë' 2016:

1. Kategoria Fason: Madish shpk;
2. Kategoria Inovacion: Albtelecom;
3. Kategoria Made in Albania: Picari shpk;
4. Kategoria 'Gruaja sipërmarrëse': Edlira Sulaj;
5. Kategoria ICT: ICT Awards Tiranë;
6. Kategoria 'Punësim në Vend të Lemoshës': Bolv Oil;
7. Kategoria 'Mikpritja e spikatur': Piazza Hotel;
8. Kategoria 'Shija e Posaçme': Padam;
9. Kategoria Start-up: Baboon.al;
10. Kategoria 'Përgjegjësia sociale': Abi Bank;
11. Kategoria Agropërpunim: Kantina 'Vila Shehi';
12. Administratorja e vitit: Sonila Qato;
13. Administratori i vitit: Artan Lame.


<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/ndahen-cmimet-per-sipermarrjen-bleta-e-arte-2016>

## Ministrja Ekonomi vizitë në Kantinën Arbëri, përfituese e AIDA-s



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi zhvilloi një vizitë në kantinën Arbëri në Rrëshen, në kuadër të tureve për të parë si ka ndikuar mbështetja financiare nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve tek bizneset përfituese gjatë këtij viti. Kantina Arbëri është një prej bizneseve që kanë përfituar fondin e konkurrueshmërisë nga AIDA, një fond ka për qëllim të mbështesë dhe të përmirësojë kapacitetet e sipërmarrjeve shqiptare në mënyrë që ato të jenë në gjendje t'u përgjigjen kërkesave të tregut ndërkombëtar, si dhe të rrisin punësimin. Vetëm gjatë vitit 2016, fondi i Konkurrueshmërisë ka mbështetur 28 kompani shqiptare, duke i ndihmuar ato të rrisin kapacitetet e tyre dhe të përmirësojnë cilësinë e produktit. Një prej këtyre bizneseve është dhe Kantina Arbëri. Gjatë kësaj vizite, pronari i kantinës shpjegoi se me fondin e AIDA-s u prodhuan etiketat për eksport të verës në SHBA dhe vende të tjera ku eksportohet vera Arbëri. Ndihma ka qenë e çmuar dhe në drejtim të ambalazhimit dhe paketimit cilësor, të cilat u bënë të mundura falë fondit të konkurrueshmërisë. Ministrja Ekonomi u shpreh se AIDA ka patur fat që ka gjetur aplikant si kantina Arbëri, sepse tek serioziteti i kësaj kompanie, garancia e projektit të suksesshëm është evidente. Ministrja Ekonomi u njoh me punën e këtij biznesi, me problematikat, sfidat dhe planet e ardhshme të këtij biznesi për zgjerimin e mëtejshëm të prodhimit dhe eksporteve. Vetëm këtë vit te AIDA kanë aplikuar 126 kompani, nga të cilat kanë fituar 86 prej tyre duke përfituar rreth 81 milionë lekë. Këto fonde i ndihmojnë bizneset të dalin në tregun e huaj, të jenë të konkurrueshme, të jenë të certifikuara për aktivitetet e tyre. AIDA ka 6 lloje fondesh për bizneset start up, artizanat, ekonomi kreative, inovacion, gruaja sipërmarrëse etj. Vetëm fondin start up këtë vit e kanë fituar 33 kompani të vogla, që kanë përfituar 10 milionë lekë me iniciativat e tyre të biznesit.

### Eksportet rriten me 17.4% në krahasim me një vit më parë



Eksportet në muajin nëntor 2016 u rritën me 17.4 % në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2015 dhe rreth 5.4 % në krahasim me muajin tetor 2016. Ky tregues bëhet i ditur nga raporti i fundit i INSTAT lidhur me ecurinë e Tregtisë së Jashtme për 11 mujorin e vitit 2016. Konkretisht, në raport thuhet se eksportet e mallrave arritën vlerën 23 mld lekë, duke u rritur me 17,4% në krahasim me Nëntor 2015. Duke krahasuar vlerën e eksporteve të muajit nëntor 2016 me një muaj më parë, tetor 2016, vihet re një rritje e tyre me 5,4%. Duhet theksuar se ndikim në rritjen vjetore të eksporteve këtë muaj e ka dhënë edhe grupi “Tekstile dhe këpucë” me +5,7 pikë përqindje. Përsa i përket ecurisë së importeve të mallrave, në muajin nëntor 2016 arritën vlerën 49 miliardë lekë, duke u rritur me 0,6 % në krahasim me nëntor 2015 dhe duke u rritur me 1,0% në krahasim me muajin tetor 2016. Shkëmbimet tregtare me BE rikonfirmohen në rritje, duke shënuar rreth 3,3 % rritje për periudhën Janar – Nëntor 2016 krahasuar me Janar – Nëntor 2015.

---

### Ministrja Ekonomi u uron festat fëmijëve të ‘Shtëpisë së Fëmijës’ Shkodër



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes znj. Milva Ekonomi vizitoi Shtëpinë e Fëmijës 6-18 vjeç, Shkodër, në kuadrin e nismës së Qeverisë për festat e fundvitit #FestatDuanDashuri. Ministrja Ekonomi shpërndau dhuratat për fëmijët e kësaj qendre. Ministrja u uroi festat fëmijëve në një atmosferë shumë festive. Fëmijët fillimisht dhanë një shfaqje të përgatitur për Vitin e Ri, dhe më pas animatorët zhvilluan lojëra të ndryshme për t'i kënaqur ata. Shtëpia e Fëmijës 6-18 vjeç në Shkodër është një institucion që administrohet nga Bashkia Shkodër. Janë gjithsej 27 përfitues në këtë qendër. Fëmijëve u ofrohen shërbime psiko-sociale, këshillim, kujdes shëndetësor, shërbime bazë si ushqim, veshmbathje, shërbim edukues si: arsim, kurse kualifikimi, kurse formimi dhe aktivitete kulturore e sportive. #FestatDuanDashuri është një nismë e drejtuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, që u zhvillua gjatë gjithë ditës 28 dhjetor në 28 qendra të kujdesit social në të gjithë vendin. Ministra, zyrtarë qeverie, përfaqësues bashkie, ishin të pranishëm në këto qendra të ndryshme për të shpërndarë dhurata, por mbi të gjitha për të krijuar atmosferë festive dhe për të dhuruar dashuri për njerëzit në nevojë dhe shtresat vulnerable të shoqërisë.

---

### Standard i ri për turizmin aventuror në Shqipëri





Në datën 31 dhjetor 2016, në ditën e ndërrimit të viteve, u transmetua në televizionet kryesore të botës, BBC, Euronews dhe Travel Channel, spoti promovues “Albania Go your own way”. Në spotin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit paraqiten atraksionet turistike e natyrore të vendit tonë si bregdeti, kultura, historia, turizmi i aventurës, kulinaria e shumë të tjera. Transmetimi ka nisur në 24 dhjetor në të tre këto televizione dhe jo më kot janë zgjedhur këto dite festive për të reklamuar Shqipërinë tonë. Është koha kur gjithë njerëzit në botë janë në ditët e tyre të pushimit, duke parë ekranet televizive, duke biseduar në familjet e tyre për bilancin e vitit 2016 dhe duke bërë planet për vitin e ardhshëm, pse jo dhe planet për udhëtimet e tyre dhe pushimet në 2017. Është koha kur agjencitë apo portalet e udhëtimeve lançojnë rekomandimet se ku duhet t’i kalojnë turistët pushimet në 2017. Dhe jo pak herë është sugjeruar Shqipëria në krye të këtyre renditjeve. Kjo fushatë e cilësuar nga ekspertët të mediave të huaja si një ndër më të suksesshmet që AKT ka bërë ndonjëherë, filloi mëngjesin e datës 24 dhjetor për të vijuar transmetimin gjatë Krishtlindjeve e deri mesnatën e datës 31 dhjetor, në këto tre kanale ndërkombëtare të ndjekura nga miliona shikues në mbarë botën.

### S Takimi përmbyllës i projektit “Në Zbulim të Mistereve të Jugut”



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi mori pjesë në takimin përmbyllës të projektit “Në Zbulim të Mistereve të Jugut”, një projekt i zbatuar nga Instituti i Librit dhe i Promocionit, i financuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Projekti solli një risi, pasi ndërlidhi kulturat e jugut me të veriut përmes një sërë aktivitetesh që u zhvilluan nga Tropoja në Himarë, Pilur e Kuç të Vlorës, si një mënyrë për të marrë eksperiencën e turizmit model malor që ofron Valbona dhe për ta zbatuar atë në zonat rurale e malore të rajonit të Himarës. Projekti në fjalë ka publikuar rreth 15 libra në dy gjuhë (me financimin e GIZ) për 15 zonat rurale të Bashkisë Himare, të cilat kanë vlera të jashtëzakonshme për t’u vizituar në çdo stinë të vitit. Botimet janë specifike për: Himarën, Borshin, Kallaratin, Qeparoin, Dhërmiun, Vranishtin, Pilurin, Kudhësi, Lukovën, Fterrën, Çorraj, Ilias, Porto Palermon, Vunoin, Kuçin. Këto botime u japin një informacion shumë të hollësishëm lexuesve shqiptarë dhe të huaj për vlerat e jashtëzakonshme historike, kulturore të këtyre zonave. Ministrja Ekonomi, duke përshëndetur këtë projekt, u shpreh e kënaqur me arritjet e tij, i cili ishte pjesë e disa projekteve për turizmin që MZHESTS financoi muajt e fundit. “Kishte një numër të madh aplikimesh dhe fusha e tyre ishte shumë e gjerë,- tha Ministrja. “Por jugu i Shqipërisë ka një specifikë pasi është shumë i kërkuar nga turistët, ndaj dhe produktet që duhet të ofrohen në këtë zonë duhet të jenë të larmishme. Qëllimi është që të zgjasim kohën e turistëve në Shqipëri, të mos qëndrojnë vetëm për plazhin dhe diellin por të ngjiten në këto zona të bukura dhe t’i eksplorojnë ato, të shohin historinë, të shikojnë gatimet tradicionale dhe të ushtrojnë pse jo sportet e aventurës si hiking etj.”, u shpreh Ministrja Ekonomi. Ky projekt ofronte njohjen e një pjesë të panjohur të jugut dhe konkretisht rrethinave të Himarës. Ministrja shtoi se ende nuk njihen gjithë destinacionet turistike që Shqipëria ofron. Ajo tha se po përgatitet kalendari gjithëvjetor i turizmit në Shqipëri, që do të ndihmojë jo vetëm në një ide më të mirë të turizmit gjithëvjetor në Shqipëri, por gjithashtu do të llogariten më mirë dhe të ardhurat që sjell turizmi në ekonomi.

## Takim në MZHETTS me shoqërinë civile për programin e reformave ekonomike



Në mjediset e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes u mbajt një tryezë e rrumbullakët konsultuese me shoqërinë civile, në kuadër të procesit për hartimin e dokumentit “Programi i Reformave Ekonomike (ERP) 2017-2019 të Shqipërisë”. Takimi u drejtua nga Sekretari i Përgjithshëm të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, z. Gentian Këri. Në fjalën hyrëse, Sekretari i Përgjithshëm, z. Gentian Këri prezantoi Programin e Reformave Ekonomike, si një dokument strategjik ku paraqiten aspektet kryesore të politikave makro ekonomike e fiskale, si dhe reformat strukturore parësore të parashikuara nga Qeveria e Shqipërisë në periudhën afatmesme, për nxitjen e rritjes ekonomike dhe rritjes së konkurrueshmërisë. “Konsultimi me grupet e interesit, organizatat ndërkombëtare donatore dhe Komisionet Parlamentare është pjesë e rëndësishme e hartimit të dokumentit të ERP”- tha z. Këri gjatë fjalës së tij. Ndërkohë nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, z. Ledion Shahini, pedagog në Fakultetin e Ekonomisë, ngriti shqetësimin në lidhje me tokën bujqësore dhe industrinë bio-ushqimore. Sipas z. Shahini një nga problemet që ka vendi ynë është fakti se, në analizën sektoriale të ekonomisë shqiptare, sektori i bujqësisë zë rreth 20% të ekonomisë vendase ndërsa nga ana tjetër sektori i agro-industrisë zë më pak se 10%. “Produktiviteti, rritet vetëm nëse ekonomia jonë do të përfitonte nga një agro-industri e zhvilluar”, theksoi z. Shahini. Shoqata shqiptare e Bankave shprehu shqetësimin për mungesën e një adresari funksional që të shfrytëzohet nga bankat, shoqëritë e telekomunikacionit etj. Gjithashtu shqetësimi u ngrit dhe për zbatimin e nënshkrimit elektronik, pasi ende prania fizike mbetet mënyra kryesore për nënshkrimin e dokumenteve të ndryshme. Tjetër shqetësim i ngritur nga shoqata e Bankave është kultura financiare shumë e ulët në shoqërinë shqiptare, e cila duhet të përmirësohet në programe apo strategji kombëtare për arsimin. Pyetje e komente të tjera u shtruan nga zv. Rektori i Universitetit të Tiranës, Z. Bernard Dosti lidhur me marrjen parasysh të vitit elektorral në realizimin e objektivave të dokumentit ERP dhe nga përfaqësuesja e Universitetit Aleksander Moisiu në Durrës lidhur me risqet që vijnë nga ndryshimi i strukturës së borxhit dhe luhatjet në kurset e këmbimit. Të gjitha pyetjet dhe diskutimet gjatë këtij takimi u adresuan nga përfaqësues të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë. Këto çështje do të shërbejnë si bazë për monitorimin e rishikimin e ERP gjatë vitit 2017, si dhe do të përfshihen në seksionin e posaçëm në dokumentin ERP.

## AIDA bashkëpunim me qeverisjen vendore për shërbimin “After Care”



Fillimi i vitit 2016 e gjeti AIDA me një përfaqëse proaktive ndaj investitorëve të pranishëm në vend. AIDA ka hartuar një program mbi përkujdesjen e vazhdueshme të investitorëve që zhvillojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri e që përballen me një problem administrativ, burokracinë, zbatimin e kontratave, infrastrukturë, çështje të lidhura me lejet/licenca/autorizime et., duke i ardhur në ndihmë nëpërmjet shërbimit After Care. AIDA sot disponon një rrjet efektiv komunikimi e bashkëpunimi me strukturat qendrore në funksion të nxitjes dhe zhvillimit të investimeve. Jo vetëm kaq, por përgjatë 2016, AIDA ka bërë funksional bashkëpunimin me qeverisjen lokale, për të qenë në një sinergji të përbashkët kundrejt përmirësimit të shërbimit ndaj investitorëve të huaj operues në Shqipëri ashtu si dhe gjenerimin ri investimeve në vend. Ky projekt bashkëpunimi është iniciuar fillimisht me Bashkinë Lezhë dhe Bashkinë Elbasan. Fillimisht takime janë zhvilluar pranë kompanive që operojnë në industrinë përpunuese të produkteve të peshkut, si Nettuno shpk dhe Poseidon. Përgjatë këtyre takimeve janë diskutuar çështje me interes të përbashkët si dhe janë ngritur problematika konkrete të sektorit, të cilat po ndiqen aktualisht për zgjidhje nga sektori i Aftercare pranë AIDA-s. Stafi i AIDA-s asiston kompanitë jo vetëm me analiza tregu, informacion mbi sektorët potencialë për zhvillim, por edhe asistencë në gjetjen të pronave dhe vendeve të përshtatshme për biznesin (Greenfield and Brownfield), apo identifikimin e projekteve të reja për bashkëpunim brenda dhe jashtë vendit



Adresa: Blvd. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Albania

Tel. / Fax: +355 42 22 34 55 / +355 42 22 34 55

E-mail: [zmp@ekonomia.gov.al](mailto:zmp@ekonomia.gov.al)

Web: [www.ekonomia.gov.al](http://www.ekonomia.gov.al)

